

Dok.	TIA-IMS-POL-001	<b>Politika e Mjedisit</b>	
Rish.	07		
Datë	01/07/2024		I brendshëm/I jashtëm

## POLITIKA E MJEDISIT

Tirana International Airport SHPK ("TIA") njih rëndësinë e ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit në Republikën e Shqipërisë. TIA është plotësisht e përkushtuar për të kontrolluar dhe minimizuar ndikimin e mundshëm në mjedis dhe në komunitetet lokale për shkak të operimit dhe zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, si dhe për të siguruar standardet e mjedisit në të gjitha ambientet e saj.

Veprimtaria jonë orientohet drejt integritetit të primeve të qëndrueshme në vendimarrje dhe në proceset tona të biznesit, duke ndërmarrë masa për ruajtjen e burimeve natyrore dhe të energjisë, si dhe mbrojtjen e ekosistemeve me qëllim maksimalizimin e përfitimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore nga rritja e vazhdueshme e aeroportit.

Ne do të planifikojmë, rishikojmë dhe përditësojmë objektivat dhe synimet tona në lidhje me mjedisin, në mënyrë që jo vetëm të jemi në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret kombëtare, por gjithashtu të përmirësojmë performancën tonë mjedisore përmes monitorimit të vazhdueshëm të kushteve mjedisore, duke ndërmarrë nisma për të menaxhuar në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi sfidat mjedisore duke ndjekur një metodë proaktive për të ardhmen.

TIA do të vazhdojë të nxisë dhe inkurajojë përdorimin e praktikave të përgjegjshme mjedisore nga punonjësit e saj. Me eksperiencën tonë në menaxhimin e mjedisit, ne do të inkurajojmë dhe do të mbështesim partnerët tanë në biznes dhe komunitetin për të marrë pjesë në një bashkëpunim më të gjerë në aeroport.

TIA ka themeluar dhe është duke zbatuar dhe mirëmbajtur një Sistem të Menaxhimit të Mjedisit (SMM) të orientuar drejt standardeve ISO 14001:2015 dhe garanton se funksionet e EMS janë të integruara në mënyrë efikase me Sistemet e tjera të Menaxhimit brenda Kompanisë dhe se përmirësohen vazhdimisht gjatë aktiviteteve tona.

Performanca dhe arritjet mjedisore do të publikohen dhe promovohen nëpërmjet publikimeve të Kompanisë.

Tirana International Airport, 1 Korrik 2024

Marsida Pallko  
Administratore e TIA-s

Piervittorio Farabbi  
Menaxher Përgjegjës i TIA-s dhe  
Administrator / COO



Page 1 of 1